

NËNTOR 2024

Dëgjoni të ardhmen

Fëmijët dhe adoleshentët bëjnë thirrje për veprim në lidhje me të drejtat e fëmijëve përballë sfidave globale

Dita Botërore e Fëmijëve është ditë globale e veprimit *për fëmijët* dhe *nga fëmijët*, e cila shënohet çdo vit më 20 nëntor, me rastin e kremtimit të përvjetorit të miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 1989.

Në vitin 2024, rreth 45 fëmijë dhe adoleshentë të moshës 13 deri në 17 vjeçare nga e gjithë Maqedonia e Veriut u mblodhën për të reflektuar mbi tre megatrendet globale, të cilat e formësojnë të ardhmen e fëmijëve: kriza klimatike, teknologjitë e avancuara dhe ndryshimet demografike. Këtu është paraqitur një pasqyrë e çështjeve të ngritura dhe thirrjeve për veprim, të cilat ata i paraqitën në Dëgjoni të ardhmen: Fëmijët e drejtojnë mbledhjen e nivelit të lartë qeveritar.

> Ky rast nuk është vetëm për ta dëgjuar atë që e mendojmë, por edhe të pranojmë se kemi ide dhe zgjidhje konkrete" Kasija, 17

Kriza klimatike

Në vazhdë e sipër vendi përballet me sfida mjedisore, me shfaqjen e valëve më të shpeshta ose të rënda të të nxehtit, përmbytjeve, zjarreve dhe zvogëlimit të rezervave të ujit. Këto kushte e kanë ulur prodhimin bujqësor. Shkupi vuan nga ndotja e rëndë e ajrit, duke kontribuar në sëmundje dhe vdekshmëri të foshnjave. Zjarret dhe prerjet e paligjshme të pyjeve kanë çuar në shpyllëzim të gjerë, në përkeqësim të cilësisë së ajrit dhe në probleme shëndetësore. Ndotja e ujit nga mbeturinat dhe kimikatet toksike e rrezikon shëndetin dhe ekosistemet, ndërsa menaxhimi i dobët i pellgjeve të lumenjve shkakton përmbytje dhe erozion të tokës. Deri në vitin 2050, situata pritet vetëm të përkeqësohet. Duke reflektuar mbi këto çështje, fëmijët dhe adoleshentët bënë thirrje për veprimet e mëposhtme:

- Përmirësimi i monitorimit dhe kontrollit të ndotjes së ajrit dhe emetimeve nga ndotësit kryesorë.
- Rritja e ripyllëzimit dhe investimeve në infrastrukturën e gjelbër dhe projektet mjedisore, si shtigjet e çiklizmit dhe subvencionet për riparimin e biçikletave.
- Promovimi i burimeve alternative të energjisë dhe reduktimi i përdorimit të lëndëve djegëse fosile përmes subvencioneve për zgjidhje miqësore për mjedisin, duke përfshirë transportin e qëndrueshëm.
- Fuqizimi i edukimi klimatik që në moshë të re për t'i përgatitur të rinjtë për sfidat klimatike.
- Forcimi i kontrollit të rregulloreve të ndërtimit urban dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe pyjeve urbane me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit.
- Prezantimi i metodave të reja për menaxhimin e mbetjeve industriale, siç është riciklimi i mbetjeve të produkte të vlefshme dhe gjenerimi i energjisë elektrike nga djegia e mbetjeve me shkarkim të minimizuar të gazrave.
- Sigurimi i hapësirës dhe mbështetjes financiare për iniciativat dhe projektet e politikave të gjelbra të udhëhequra nga të rinjtë.

Teknologjitë e avancuara

Vendi përballet me pabarazi të konsiderueshme digjitale, veçanërisht në shkollat rurale, të cilat nuk kanë infrastrukturë të përshtatshme. Për më tepër, ka mungesë të burimeve arsimore digjitale të qasshme dhe me cilësi të lartë. Rritja e vëllimit të të dhënave digjitale e rrit rrezikun e keqpërdorimit të informacioneve të ndjeshëm. Kujdesi shëndetësor i vendit përballet me shumë sfida, të cilat mund të adresohen përmes përparimeve në teknologji. Fëmijët dhe adoleshentët kërkuan të ndërmerren veprimet e mëposhtme, me qëllim të shfrytëzimit të fuqisë së teknologjive të avancuara për t'i shtyrë përpara të drejtat e fëmijëve:

- Investimi në infrastrukturën digjitale në të gjitha shkollat, veçanërisht në zonat rurale, me qëllim të ofrimit të barazisë digjitale për secilin fëmijë.
- Zhvillimi i programeve për edukimin mbi IA-në si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit në mënyrë që ata të përgatiten më mirë për të ardhmen, me fushëveprim gjithnjë e më të madh të botës digjitale.
- Miratimi i kornizave rregullatore për përdorimin etik të IA-së me fokus në ruajtjen e privatësisë së fëmijëve.
- Përfitimi nga përdorimi i IA-së për ta zhvilluar një bazë njohurish digjitale, të qasshme në nivel nacional, të disponueshme për të gjithë nxënësit.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale për ta monitoruar dhe analizuar suksesin e nxënësve, duke përmirësuar programet mësimore dhe metodologjitë për mësim të personalizuar, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Investimi në kujdesin shëndetësor të përqendruar në IA, me qëllim të nxitjes së inovacionit dhe përmirësimit të cilësisë së kujdesit.
- Përdorimi i IA-së për analiza të avancuara të të dhënave shëndetësore, për të krijuar politika shëndetësore dhe për të hartuar masa parandaluese, si fushatat e vaksinimit.

Ndryshimi demografik

Maqedonia e Veriut përballet me migrim të përhapur gjithandej për shkak të kërkimit të kushteve më të mira jetësore, arsimit më cilësor dhe mundësisë së punës, duke shpirë në vetmi dhe zhgënjim të atyre që ngelin në vend. Kushtet e këqija të shkollave dhe materialet e papërshtatshme mësimore ndikojnë në cilësinë e arsimit. Migrimi urban drejt kryeqytetit në kërkim të një kujdesi më të mirë shëndetësor dhe vendeve të punës rezulton në shpopullim të mjediseve rurale. Fëmijët ndihen të neglizhuar dhe të papërfillur me seriozitetin e duhur, gjë që shpie në pakënaqësi. Mungesa e infrastrukturës sociale dhe kulturore ndikon në jetën dhe zhvillimin e tyre shoqëror. Perceptimet negative për vendin e nxisin dëshirën për të emigruar. Prandaj për të promovuar mundësi të barabarta dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve demografike, fëmijët dhe të rinjtë kërkuan veprimet e mëposhtme:

- Përmirësimin e infrastrukturës në fshatra, duke përfshirë rrugët, transportin publik dhe shkollat.
- Sigurimin e qasjes së barabartë në shëndetësi, arsim, shërbime sociale dhe internet të qëndrueshëm në zonat rurale.
- Investimin në trajnimin e mësuesve, investimin në metodat moderne të mësimdhënies dhe edukimit digjital, veçanërisht në zonat rurale.
- Sigurimin e kushteve dhe mundësive më të mira të jetesës në zonat rurale, me qëllim të reduktimit të emigracionit.
- Përmirësimin e spitaleve shtetërore, sigurimin e pagave dhe kushteve më të mira për mjekët e rinj dhe sigurimin e kontrolleve vjetore parandaluese.
- Krijimin e inkubatorëve të biznesit dhe ofrimin e mbështetjes për të rinjtë për të filluar dhe zhvilluar biznese lokale.
- Organizimin e më shumë aktiviteteve kulturore, hapjen e kinemave dhe teatrove dhe krijimin e hapësirave për tubime rinore, duke përfshirë edhe zonat rurale.
- Promovimin e optimizmit dhe ndërtimin e atmosferës pozitive për ta inkurajuar përfshirjen e komunitetit dhe optimizmin për të ardhmen.
- Krijimin e platformave për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe sigurimi që zëri i tyre të dëgjohet dhe respektohet.
- Kalimi nga premtimet në veprime reale, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie nga qeveria.

"Sot e kishim mundësinë t'i ndajmë vizionet, shpresat dhe idetë tona për një të ardhme më të mirë me të gjithë ju që e keni fuqinë dhe përgjegjësinë për t'i kthyer këto vizione në realitet" Kasija, 17 vjeç.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)
Orce Nikolov 74, 1000 Shkup www.unicef.mk tel: +389 2 3231150
e-mail: skopje@unicef.org Ndiqni UNICEFMK në Facebook, Twitter, Instagram, YouTube, LinkedIn